

**RAPORTI PERIODIK Numër 1\***  
**13–25 Shkurt 2009**

**I. REZIME**

- Zgjedhjet për President, Kryetarë dhe këshilltarë të komunave do të mbahen më 22 Mars të vitit 2009. Në rast se asnjëri nga kandidatët për President nuk fiton shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar, atëherë pas dy javësh do të mbahet rrethi i dytë i zgjedhjeve mes dy kandidatëve që kanë fituar numrin më të madh të votave në rrethin e parë.
- Në zgjedhjet për President të shtetit do të garojnë shtatë kandidatë. Gjithsej janë dorëzuar kandidatura për 374 kandidatë për kryetarë të komunave dhe 703 lista për këshilltarë për zgjedhje të 84 Kryetarëve dhe këshillave komunal, dhe Kryetar dhe këshill komunal për Qytetin e Shkupit.
- Zgjedhjet po zhvillohen në përpuethshmëri me Ligjin për Zgjedhje, i cili kohë më parë pësoi ndryshime me qëllim përfshirjen e rekomandimeve të dhëna nga Zyra e OSBE-së për institucione demokratike dhe të drejta të njeriut (OSBE/ODIHR), përfshirë këtu edhe dispozitat e përmirësuara për zgjidhjen e ankesave dhe për financimin e fushatave zgjedhore.
- Zgjedhjet do të administrohen nga një administratë zgjedhore e përbërë nga tre nivele, edhe atë nga Komisioni shtetëror zgjedhor (KShZ), 84 Komisione zgjedhore komunale (KZK) dhe Komisioni zgjedhor i Qytetit të Shkupit, dhe 2976 Këshillat zgjedhor (KZ).
- KShZ me përbërjen aktuale është emruar më 4 Dhjetor, të vitit 2008. Duket që funksionon në mënyrë transparente dhe apatiake, dhe gëzon besimin e shumicës së partive politike. Edhe pse KShZ ka mungesë të resurseve adekuate njerëzore dhe hapsirave për punë, përgatitjet e tyre për zgjedhjet në përgjithësi po zhvillohen në mënyrë të duhur.
- Trajnimi i KZK-ve dhe policisë janë në rrjedhë e sipër. Përbërja e KZ-ve është ndryshuar për të përfshirë nga dy anëtarë të nominuar nga partitë politike. Ligji për zgjedhje kërkon përfaqësim “adekuat dhe të drejtë” të grupeve etnike dhe grave në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore.
- Më 22 Shkurt, liderët e katër partive më të mëdha zhvilluan takimin e parë të një sërë takimesh që do të zhvillohen edhe në të ardhmen, ku ranë dakord të punojnë së bashku për zgjedhje demokratike dhe të kërkojnë mënyrë për të shmangur parregullsitë që njollosën disa procese të kaluara zgjedhore.
- Janë raportuar disa incidente me prapavijë politike në disa vende të ndryshme dhe Misioni për vëzhgimin e zgjedhjeve (MVZ) është informuar për disa akuza shqetësuese për frikësim.
- Periudha oficiale e fushatës zgjedhore nuk fillon para 2 Marsit dhe ekzistojnë rregulla strikte në lidhje me zhvillimin e fushatës aktive para datës së caktuar. Këshilli për radiodifuzion ka inicuar padi kundërvajtëse dhe ka dhënë vërejtje për disa televizione që kanë shkelur rregullat strikte të mbulimit medial para fillimit zyrtar të fushatës zgjedhore.

\* Verzioni i vetëm zyrtar i këtij dokumenti është verzioni në gjuhën angleze.

- Vetëm një pjesë të vogël të personave të akuzuar për shkelje në lidhje me zgjedhjet e vitit 2008 u është shqiptuar dënim. Anëtarët e KZK-ve dhe KZ-ve të akuzuar për shkelje në vitin 2008 janë mënjeluar nga këto organe dhe ndaj policëve që janë dëshmuar të kenë qenë të përfshirë në shkelje të procesit zgjedhor janë ndërmarrë masa disiplinuese.
- Misioni i OSBE/ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve ka hapur zyrën e vet në Shkup më 13 Shkurt, me një personel qëndror 12 anëtarësh dhe 24 vëzhgues afat-gjatë që janë shpërndarë dhe vendosur në 11 qytete në tërë vendin.

## II. HYRJE

Zgjedhjet Presidenciale dhe ato Komunale do të mbahen më 22 Mars 2009, në përpuethshmëri me dispozitat kushtetuese dhe ligjore. Në bazë të Misionit për vlerësim të nevojave, dhe në ftesë të Ministrisë për punë të jashtme, Zyra e OSBE-së për institucione demokratike dhe të drejta të njeriut (OSBE/ODIHR) më 13 Shkurt themeloi Misionin për vëzhgimin e zgjedhjeve. Misioni, i udhëhequr nga z. Pitër Ajker, përbëhet nga 12 anëtarë të vendosur në Shkup dhe 24 vëzhgues afat-gjatë të shpërndarë më 18 Shkurt në 11 qytete të vendit. Misioni i OSBE/ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve është krijuar nga 25 shtete pjesëmarrëse të OSBE-së. Nga Shtetet pjesëmarrëse është kërkuar të dërgojnë 300 vëzhgues afat-shkurtër për të vëzhguar hapjen, votimin, numërimin dhe përpunimin e votave.

## III. HISTORIATI

Mandati pesë-vjeçar i Presidentit Branko Červenkovski skadon në Maj të vitit 2009. Presidenti është Komandant i përgjithshëm i Forcave të armatosura dhe President i Këshillit të sigurisë, dhe disa kompetenca tjera siç janë caktimi i mandatarit për formimin e Qeverisë, emërtimi i Ambasadorëve, dhe emërtimi i disa gjykatësve. Edhe pse nuk i mohoet e drejta për t'u kandiduar për mandat të dytë, Presidenti aktual deklaroi që nuk do të kërkojë rizgjedhje dhe se planifikon të kthehet në udhëheqësinë e partisë së tij, Lidhjes Social –Demokrate të Maqedonisë (LSDM).

Mandatet e 84 kryetarëve të komunave dhe këshillave komunal, si dhe të kryetarit dhe këshillit komunal të Qytetit të Shkupit (i përbërë nga dhjetë komuna), skadojnë në fund të muajit Mars 2009. LDSM-ja për momentin ka 34 komuna, më shumë se të gjitha partitë tjera.

Zgjedhjet presidenciale dhe komunale do të realizohen pas as një viti të plotë nga zgjedhjet parlamentare të 1 Qershorit, për të cilat MVZ i OSBE/ODIHR-it konkludoi që “në përgjithësi [...] nuk plotësuan përkushtimin dhe kërkesat kyçe të OSBE-së”, veçanërisht për shkak të dhunës dhe parregullsive që u shfaqën. Pas zgjedhjeve, koalicioni i zgjedhur i udhëhequr nga VMRO-DPMNE formoi koalicionin qeveritar me partinë shqiptare Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) dhe Partinë për Ardhmëri Evropiane (PEI); koalicioni ka shumicën e deputetëve në Parlament, me 82 ulëse nga gjithsej 120. Shumica e bashkëbiseduesve presin që zgjedhjet komunale të jenë më ashpër të garruara nga ato presidenciale.

## IV. RRETHANAT POLITIKE

Zgjedhjet e 22 Marsit janë vështruar si një test kryesor i shpresave të vendit për hapat e mëtejshëm drejt integritimeve Euro-Atlantike, qëllim i përbashkët i të gjitha partive të mëdha politike. Kryetari i qeverisë ka thirr disa takime me liderët e katër partive më të mëdha politike të përfaqësuara në kuvend - VMRO-DPMNE-së, LDSM-së, BDI-së dhe Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH) - me qëllim promovimin e procesit demokratik zgjedhor. Në një shënim të shprehjes së vullnetit të mirë të liderëve të partive, këto takime përfunduan me marrëveshje ndër-

partiake mbi një sërë çështjesh të rrezikshme zgjedhore. Takimi i fundit i 22 Shkurtit, rezultoi me marrëveshje mbi rolin e policisë në ditën e zgjedhjeve, koordinimin ndër-partiak dhe masave mbrojtëse procedurale për sigurim të integritetit të procesit të votimit.

Shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së të OSBE/ODIHR-it kanë theksuar që roli i duhur i policisë dhe agjensive për zbatim të ligjit në parandalimin e dhunës të motivuar nga zgjedhjet do të jetë thelbësor për mbarëvajtjen e zgjedhjeve demokratike. Më 18 Shkurt, Ministria e punëve të brendshme ka prezantuar një plan të përgjithshëm për siguri për zgjedhjet e ardhshme. Plani bazohet drejtëpërdrejtë në përvojën nga zgjedhjet e vitit 2008. Plani do të zbatohet nga tetë zyre rajonale të policisë, në koordinim me komandirët e stacioneve policore lokale dhe do të inkorporohet në planin e përgjithshëm për shpërndarje dhe sistematizim të policisë që do të finalizohet më tej.

Në garën për President garrojnë gjithsej shtatë kandidatë: Imer Selmani (Demokracia e Re), Mirushe Hoxha (Partia Demokratike Shqiptare), Nano Ruzhin (Partia Liberal-Demokratike), Gjorge Ivanov (VMRO-DPMNE), Lube Boshkovski (kandidat i pavarur), Agron Buxhaku (BDI), dhe Lubomir Fërçkovski (LDSM). Gjashtë prej kandidatëve përkrahen nga parti politike, por vetëm dy prej tyre janë anëtarë aktivë të partive që i kanë nominuar. Katër prej kandidatëve janë akademikë dhe profesorë univerzitarë.

Fushata zgjedhore 20-ditëshe fillon më 2 Mars dhe do të zgjasë deri më 21 Mars. Neni 2.13 nga Ligji për zgjedhje jep një definicion të gjërë për fushatën zgjedhore si një prezentim publik i kandidatëve gjatë periudhës para-zgjedhore. Në përgjithësi, deri më tani partitë politike dhe kandidatët kanë respektuar dispozitat ligjore në lidhje me fushatën zgjedhore, edhe pse shumë kandidatë dhe liderë të partive kanë qenë aktivë duke dhënë deklaratë për media, prej të cilave disa kanë qenë jomodeste dhe fyese. Fushatat qeveritare të profilit të lartë që promovojnë politikën e qeverisë janë ndërprerë që në momentin kur janë caktuar zgjedhjet.

MVZ-së së OSBE/ODIHR-it nga një numër i bashkëbiseduesve, përfshirë kandidatë dhe përfaqësues të kandidatëve, liderë të partive politike dhe nga qytetarë, i janë raportuar disa akuza për frikësim dhe presion nga autoritetet. Më brengosëse janë akuzat për frikësim me humbje të vendeve shtetërore të punës, humbje të pensione apo vendbanimeve të personave që përkrahin kandidatët opozitar, gjithashtu edhe gjatë procesit të grumbullimit të nënshkrimeve.

MVZ i OSBE/ODIHR-it deri më tani ka regjistruar disa incidente të dhunshme që haptasi kanë të bëjnë me zgjedhjet, siç ishte rasti me thyerjen e zyrës së një partie politike në Çair, dëmtim të flamujve partiak para zyrës së një partie në Makedonska Kamenica, dhe përleshje fizike mes aktivistëve të PDSH-së dhe BDI-së në Tetovë.

Sipas të dhënave nga Ministria e drejtësisë, nga gjithsej mbi 200 persona të paditur për vepra kundërvajtëse gjatë zgjedhjeve të vitit 2008, vetëm 18 janë dënuar. Një numër rastesh tjera janë akoma në procedurë. Për më tepër, anëtarët e KZK-ve dhe KZ-ve të akuzuar për shkelje të procesit zgjedhor të vitit 2008 janë mënjanuar nga këto organe, dhe ndaj policëve që janë dëshmuar të kenë qenë të përfshirë në shkelje të procesit zgjedhor janë ndërmarrë masa disiplinuese.

## V. KORNIZA LIGJORE DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Korniza ligjore për zgjedhjet presidenciale dhe ato komunale është konsoliduar me një Ligj gjithëpërfshirës për zgjedhje të miratuar në vitin 2006. Në Tetor 2008, Parlamenti miratoi një sërë ndryshimesh të Ligjit për zgjedhje. Ndryshimet u referoheshin disa rekomandimeve të dhëna nga OSBE/ODIHR-i, siç është përmirësimi i dispozitave për zgjedhje të ankesave dhe për

financimin e fushatave zgjedhore. Megjithatë, disa rekomandime tjera të OSBE/ODIHR-it nuk u implementuan ose u implementuan vetëm pjesërisht. Ligji për zgjedhje akoma përmban dispozita që nuk janë mirë të definuara dhe kanë mungesë të detajeve, andaj lënë hapsirë për interpretime konfliktuoze apo procedura jo të sakta.

Presidenti zgjedhet drejtëpërdrejtë për një mandat pesë vjeçar dhe mund të ri-zgjedhet vetëm një herë. Për të fituar zgjedhjet që në rrethin e parë të votimit, kandidati duhet të fitojë votat e shumicës së numrit të përgjithshëm të votuesve të regjistruar. Kjo dispozitë bën të pamundur që një kandidat të zgjidhet në rrethin e parë. Nëse asnjë kandidat nuk plotëson kushtet, dy kandidatët më të suksesshëm vazhdojnë garrën në rrethin e dytë dy javë pas atij të parit. Kandidati i cili merr më tepër vota në rrethin e dytë zgjedhet president, nëse në zgjedhje dalin së paku 40% e votuesve të regjistruar. Në të kundërtën, i tërë procesi zgjedhor duhet të përsëritet.

Këshilltarët komunal zgjedhen përmes një sistemi për përfaqësim proporcional me lista të mbyllura, pa një kusht të parashikuar rreth numrit të votuesve. Kandidati për Kryetar komune zgjedhet në rrethin e parë nëse ai/ajo fiton më shumë se 50 përqind të votave të dhëna, nëse të paktën një e treta e votuesve të regjistruar në asaj komune dalin në zgjedhje. Nëse nuk ka fitues që në rrethin e parë, rrethi i dytë mbahet pas dy javësh mes dy kandidatëve që kanë fituar numrin më të madh të votave. Fitues është kandidati që fiton shumicën e votave. Për rrethin e dytë nuk ka ndonjë kusht për përqindjen e votuesve që dalin në votim.

## VI. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Ligji për zgjedhje themelon administratë zgjedhore prej tre nivelesh për të gjitha zgjedhjet, që përbëhet nga Komisioni shtetëror zgjedhor (KShZ), 84 Komisione zgjedhore komunale (KZK) dhe Komisioni zgjedhor i Qytetit të Shkupit, dhe 2976 Këshilla zgjedhor (KZ).

Ndryshimet e fundit në Ligjin për zgjedhje rezultuan me nevojën për përcaktimin e përbërjes së re të KShZ-së nga ana e Parlamentit për të mbikqyr administratën e zgjedhjeve; megjithatë, me përjashtim të tre anëtarëve, të gjithë anëtarët tjerë të KShZ-së janë nga përbërja e tij e mëparshme. Kryetari i KShZ-së dhe dy anëtarët tjerë janë nominuar nga partitë parlamentare opozitare, ndërsa Zëvendës Kryetari dhe tre anëtarë janë nominuar nga partitë shumicë. KShZ funksionon në mënyrë transparente, me seanca të hapura për vëzhguesit e akredituar, përfaqësues të akredituar të partive dhe kandidatëve, dhe mediave të akredituara. KShZ mban seanca të shpeshta dhe duket të funksionojë në frymën e konsensusit. KShZ duket të gëzojë besimin nga shumica e partive politike. Edhe pse KShZ aktuale funksiononte pothuajse për një muaj kur u caktuan zgjedhjet, edhe përkaj mungesës së tyre të resurseve adekuate njerëzore dhe hapsirave për punë, në përgjithësi përgatitjet për zgjedhjet po zhvillohen në mënyrë dhe në kohë të duhur.

KZK-të dhe KZ-të janë formuar brenda kohës së parashikuar me Ligjin për zgjedhje, me selektim të rastësishëm të nëpunësve shtetëror dhe duke respektuar parimin e përfaqësimit “adekuat dhe të drejtë” të komuniteteve joshumicë dhe përkatësisë gjinore. Më 24 Shkurt 2009 KShZ miratoi udhëzime të reja për të aplikuar këto kushte dhe kërkesa. Ndryshimet e fundit në Ligjin për zgjedhje parashikojnë përfaqësim partiak në KZ-të, me nga një anëtar të nominuar bashkarisht nga të dy partitë më të mëdha në Kuvend, dhe një anëtar të nominuar nga dy partitë më të mëdha opozitare. KZK-të duket që në përgjithësi janë të përgatitura për zgjedhje. Nga 25 KZK të vizituara deri më tani nga vëzhguesit afat-gjatë, vetëm KZK-të në Pehçevë dhe Saraj janë ankuar për mungesë të fondeve.

KShZ ka filluar me një program obligues për trajnim të komisioneve të niveleve më të ulëta. Trajnimi i policisë në lidhje me rolin e tyre gjatë zgjedhjeve është gjithashtu në rrjedhë.

Më 18 Shkurt, KShZ bëri tërheqjen e rradhitjes dhe pozitës së kandidatëve në fletëvotimin për President shteti. Procesi i njejtë u zbatua nga KZK-të në lidhje me zgjedhjet komunale.

## VII. REGJISTRIMI I VOTUESVE DHE KANDIDATËVE

Ministria e drejtësisë është përgjegjëse për plotësimin dhe mirëmbajtjen e listave të votuesve deri më 1 Shtator 2009 kur kjo përgjegjësi do t'i bartet KShZ-së. Listat e votuesve janë bërë publike për kontroll, edhe atë nga 20 Janari deri më 3 Shkurt 2009. Gjithsej 195 323 qytetarë kanë kontrolluar të dhënat e tyre brenda kësaj periudhe dhe janë bërë 1.525 ndryshime në të. Listat e votuesve janë mbyllur më 18 Shkurt 2009.

Në vend janë të regjistruar 1.792.082 votues. Disa bashkëbisedues janë ankuar që ky numër është i lartë në masa disproporcionale në raport me numrin e përgjithshëm të popullatës në vend, dhe që prezenca e një numri të madh të shtetasve që qëndrojnë jashtë vendit dhe janë në lista të hapsirë për manipulim. Rekomandimi i mëparshëm i OSBE/ODIHR-it për të bërë një revizion thelbësor mbi listat e votuesve akoma nuk është zbatuar.

Afati i fundit për dorëzim të listave të kandidatëve ishte 15 Shkurti. Të shtatë kandidaturat për President të dorëzuara në KShZ janë konfirmuar. Disa kandidatë të mundshëm nuk patën sukses në grumbullimin e 10.000 nënshkrimeve të nevojshme për regjistrim të kandidatëve për president. Për zgjedhjet komunale, KZK-të dhe Këshilli zgjedhor i Qytetit të Shkupit pranoi gjithsej 374 kandidatura për Kryetar të komunave dhe 703 lista me kandidatë për këshilltarë komunal.

Grumbullimi i nënshkrimeve për përkrahje të kandidatëve është tejet i vështirë dhe kufizues ngase qytetarët mund të nënshkruajnë vetëm për një kandidat për garrë dhe ngase personalisht duhet të shkojnë të japin nënshkrim në zyrën lokale apo rajonale të Ministrisë së drejtësisë. Shumica e kandidatëve për President informuan MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se roli i partive politike është kritik në procesin e grumbullimit të nënshkrimeve të nevojshme. Disa nga kandidatët dhe kandidatë të mundshëm janë ankuar që sistemi nuk është i drejtë dhe fer për kandidatët e opozitës, pjesërisht për shkak se shumë qytetarë janë frikuar të vizitojnë një zyrë qeveritare të regjistrojnë përkrahjen e tyre për një kandidat të opozitës.

## VIII. MEDIAT

Ekziston një shumëllojshmëri e mediave, duke përfshirë rreth 150 TV dhe radio stacione dhe një numër të mediave të shkruara, me 10 gazeta të përditshme. Gjithashtu janë të pranishme edhe TV kanalet e huaja, ose përmes satelitëve ose përmes rrjeteve kablloviqe në rajonet urbane. TV kanalet kombëtare private dominojnë në tregun e marketingut; televizioni është mediumi dhe burimi kryesor informimit politik.

Ligji për zgjedhje dhe Ligji për radiodifuzion krijojnë kornizën ligjore bazë sipas të cilës udhëhiqet fushata në media. Këshilli për radiodifuzion (KR), organi që vëzhgon punën e mediave po funksionon me vetëm gjashtë nga nëntë anëtarë të autorizuar ngase Kuvendi nuk arriti të plotësojë tre pozita të lira brenda Këshillit, duke kufizuar kështu aftësinë e tij për të funksionuar në mënyrë efektive. Më 16 Janar, KR miratoi rregulloren mbi mënyrën se si mediat duhet të mbulojnë zgjedhjet (Rregullore për qasje të barabartë në prezntimin medial gjatë fushatës zgjedhore). Rregullorja u miratua drejtëpërdrejtë nga KR, për dallim nga zgjedhjet e kaluara kur kjo ka qenë përgjegjësi e Parlamentit.

Sipas Rregullores, mediat duhet të sigurojnë mbulim të barabartë për të gjithë kandidatët për President. Mbulimi i kandidatëve në zgjedhjet komunale nga mediat kombëtare duhet të jetë

proporcional, duke u bazuar në numrin e përgjithshëm të kandidatëve për kryetarë komunash dhe listave të këshilltarëve të dorëzuara nga çdo parti politike. KR kërkon që mediat lokale të sigurojnë mbulim të barabartë për të gjithë garruesit në zgjedhjet lokale. Mediat publike janë të obliguara të gjejnë kohë të lirë për kandidatët dhe nuk u lejohej të ofrojnë reklamim politik me pagesë. Mediat private mund të emitojnë reklama të paguara politike me kufizim prej 15 minutash në një orë, me çmime të njejta për të gjithë kandidatët.

KR ka mandat të bëjë monitorim të mbulimit medial jo vetëm gjatë periudhës zyrtare të fushatës, por nga momenti kur caktohen zgjedhjet. Në kornizë të mandatit të tij të zgjëruar, më 16 Janar KR shpalli udhëzime për periudhën para fillimit të fushatës, sipas të cilave mediat kanë të drejtë të emitojnë mbulim të kufizuar të zgjedhjeve në edicionet e lajmeve dhe nuk kanë të drejtë të emitojnë mbulime tjera që kanë të bëjnë me zgjedhjet, përfshirë, për shembull, intervista me liderë partiak apo kandidatë potencial apo të regjistruar.

Në përgjithësi, kufizimet e vendosura përmes udhëzimeve nuk u mirëpritën nga mediat, por pas shqiptimit të disa vërejtjeve dhe inicimeve për padi kundërvajtëse ndaj disa mediave nga ana e KR, mediat në përgjithësi respektuan udhëzimet. Si rezultat i kësaj, mbulimi i zgjedhjeve në mediat e monitoruara deri më tani ka qenë i kufizuar. Edhe pse udhëzimet janë tejet kufizuese, duket që Këshilli radiodifuziv deri më tani ka zbatuar ato në mënyrë objektive dhe të ndershme, dhe qasja e këshillit duket të ketë mënjanuar problemin e mbulimit politik joadekuat të kandidatëve gjatë periudhës parazgjedhore.

Që nga 16 Shkurti, MVZ i OSBE/ODIHR-it është duke bërë analiza kuantitative dhe kualitative të prezantimit dhe mbulimit në kohën më të shikuar të dy kanaleve publike televizive (MTV-1 dhe MTV-2) dhe katër kanaleve kombëtare private (A1, Alsat-M, Kanal 5 dhe Sitel), si dhe të lajmeve të mbrëmjes të TV Alfa. Gjithashtu po monitorohen edhe pesë gazeta ditore (*Dnevnik, Koha, Lajm, Nova Makedonija* dhe *Vreme*).

## IX. ANKESAT

KShZ është organi kompetent që merret me ankesat nga kandidatët dhe votuesit në lidhje me procedurat zgjedhore, përfshirë edhe votimin, numërimin dhe përpunimin e votave. Vendimet e KShZ-së mund të ankohen para Gjyqit administrativ. Ankesat nga kandidatët dhe partitë në lidhje me të drejtat e tyre gjatë periudhës zyrtare të fushatës duhet të dorëzohen në Gjyqet e shkallës së parë, për vendimet e të cilëve më tej mund të dorëzohen ankesa në Gjyqin e apelit.

KShZ ka inicuar dy procedura akuzuese para Gjyqit të shkallës së Parë 1 në Shkup, kundër Unionit Social-Demokratik dhe Aliancës Maqedonase, për zhvillim të fushatës jashtë periudhës të parashikuar me Ligj (shkelje të Nenit 74.1 nga Ligji për zgjedhje).

KR ka inicuar disa procedura para Gjyqit të shkallës së Parë 1 në Shkup, kundër TV Kanal 5, TV Sitel (dy veprime), TV Sitel 3, TV Alsat dhe TV A1, për shkelje të Nenit 74.1. Të gjithë seancat gjyqësore kundër mediave janë caktuar për në fund të muajit Shkurt ose në fillim të muajit Mars. Për më tepër, KR ka shqiptuar disa vërejtje për disa media për parregullsi më të vogla.

Nuk janë parashtruar ankesa formale në lidhje me regjistrimin e kandidatëve për President. Dy kandidatë të mundshëm për kryetar komunash, gjegjësisht prej Gostivarit dhe Çashkës, kanë dorëzuar ankesa në Gjyqin administrativ për vendimin e KZK-ve përkatëse për të refuzuar kandidaturat e tyre. Gjyqi administrativ ktheu mbrapsht vendimin e KZK-së së Gostivarit dhe vërtetoi atë të KZK-së në Çashkë.

KShZ ende nuk ka miratuar rregulla apo udhëzime në lidhje me mënyrën se si duhet të zgjidh ankesat.

Procedura për mbrojtjen e të drejtave të kandidatëve siç është e paraparë në Nenin 73 të Ligjit për zgjedhje mbetet e paqartë. Edhe pse Ligji përcakton që Gjyqet e shkallës së parë (ndonjëherë të quajtur Gjyqet bazë apo Gjyqe primare) duhet të merren me këto raste, të dy Gjyqet e shkallës së parë të Shkup informuan MVZ-në e OSBE/ODIHR-it që mbrojtja e të drejtave të kandidatëve nuk është në kornizë të kompetencave të tyre.

## **X. PJESËMARRJA E GRAVE DHE KOMUNITETEVE JOSHUMICË**

Vetëm një nga shtatë kandidatët për President, Mirushe Hoxha (PDSH), është grua. Nga 120 anëtarët e Parlamentit, 38 (32,7 përqind) janë gra, si dhe dy nga 22 Ministrat e Qeverisë (Ministri për punë të brendshme dhe Ministri për kulturë). Në zgjedhjet komunale të vitit 2005, tre gra u zgjedhën për Kryetarë të komunave; megjithatë asnjëra prej tyre nuk ka hyrë në garrë për mandat të dytë. Ligji për zgjedhje përfshin mekanizma për përfaqësim të drejtë gjinor në administratën zgjedhore, por Parlamenti nuk përmbushi këtë kërkesë kur emërtoi anëtarët e KShZ-së (vetëm një nga shtatë anëtarët është grua). Gjatë zgjedhjeve të rradhës, një nga çdo tre vende në listën e kandidatëve për këshilltarë komunash duhet të jetë i rezervuar për “gjininë më pak të përfaqësuar”. Rrjeti i organizatave të grave “Antiko” ka lancuar një fushatë për informim publik që synon edukimin e grave për të drejtat e tyre zgjedhore dhe luftën kundër votimit familjar.

Ligji për zgjedhje parasheh përfshirjen e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë në komisionet zgjedhore në të gjitha rajonet ku ata përbëjnë së paku 20 përqind të popullatës. Në këto rajone edhe materialet zgjedhore duhet të jenë në gjuhën e komuniteteve joshumicë. Pjesëtarët e disa komuniteteve joshumicë mbajnë pozita ose si anëtarë të partive politike të komuniteteve joshumicë ose si anëtarë të partive kombëtare. Partia Demokratike e Turqve në Maqedoni (PDTM) ka kandidatët e vet për kryetar komunash dhe këshilltarë në, së paku, tre komuna (Gostivar, Pllasnicë, Centar Zhupa), ndërsa Partia Demokratike e Serbëve në Maqedoni (PDSM) ka kandidatët e vet për dy komuna (Staro Nagoriçane dhe Çučer Sandevo), që përkrahen nga VMRO-DPMNE. Fijat Canoski, lider i PIE, që përfaqëson një komunitet të vogël që quajnë veten Myslimanë Maqedonas, është kandidat për kryetar të Strugës. Partitë që përfaqësojnë komunitetin Romë kanë dy kandidatë në komunën Shuto Orizarë në Shkup.

## **XI. VËZHgues VENDOR DHE NDËRKOMBETAR**

Ligji për zgjedhje mundëson vëzhgim të procesit zgjedhor nga shoqata qytetarësh, shoqata të huaja, organizata ndërkombëtare dhe përfaqësues të shteteve të huaja. KShZ miratoi dhe shpalli Kodin për vëzhguesit ku përcaktohen të drejtat dhe përgjegjësitë e të gjithë vëzhguesve, dhe procedura për akreditim.

Asociacioni qytetar MOST planifikon të ketë përpjekjen më të madhe vendore për vëzhgimin e zgjedhjeve. MOST synon të shpërndajë në teren 3750 vëzhgues në ditën e zgjedhjeve dhe të bëjë përpunim paralel të votave (PVT) për zgjedhjet presidenciale dhe për zgjedhje të kryetarit të komunës dhe anëtarëve të këshillit për Qytetin e Shkupit.

## **XII. AKTIVITETET E MVZ-SË SË OSBE/ODIHR-IT**

MVZ i OSBE/ODIHR-it më 13 Shkurt 2009 hapi zyrën në Shkup. Shefi i Misionit realizoi takime me Kryeministrin, Zëvendës Kryeministrin përgjegjës për integrim europian, Ministrin e drejtësisë, Sekretarin shtetëror të Ministrisë për punë të jashtme, Kryetarin e KShZ-së, Kryetarin

e Këshillit radiodifuziv dhe zyrtarë të tjerë, si dhe me Shefin e Misionit vëzhgues të OSBE-së në Shkup, Përfaqësuesin special të Unionit Evropian, dhe Ambasadorët e Shteteve pjesëmarrëse në OSBE. MVZ i OSBE/ODIHR-it ka realizuar takimet e para dhe ka themeluar kontakte të rregullta me KShZ-në dhe KZK-të, kandidatët për President dhe kryetarë komunash, partitë më të mëdha politike, shoqatat qytetare dhe mediat.